



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.8/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Rugova Husaj, dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP) parashtruar kundër Vendimit Nr. 01/3689 - 2025, të datës 08.12.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Dizajnit dhe Përmbajtjes së Fletëvotimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 10.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

PRANOHET E BAZUAR ankesa ZP.Anr.8/2025, e datës 09.12.2025, e parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP) me seli në Komuna Prizren, **NDRYSHOHET** pjesërisht Vendimi Nr. 01/3689-2025, i datës 08.12.2025, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Dizajnit, Përmbajtjes së Fletëvotimit, dhe broshurave për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, ashtu që në përmbajtjen e fletëvotimit, dhe broshurave përveç gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe të përfshihet edhe gjuha turke vetëm për Komunën e Prizrenit, dhe Komunën e Mamushës.

A r s y e t i m

Me datë 09.12.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP) parashtruar kundër Vendimit Nr. 01/3689-2025, i datës 08.12.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Dizajnit dhe Përmbajtjes së Fletëvotimit, për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, ku përmes ankesës shpreh kundërshtimin e vendimit Nr.01/3689-2025, me të cilin është miratuar dizajni dhe përmbajtja përfundimtare e fletëvotimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi në pjesën ku fletëvotimi për përdorim në komunat (Prizren dhe Mamushë) ku gjuha turke ka status zyrtar nuk është përfshirë përdorimi i gjuhës turke dhe urdhërimin e KQZ-së, që të ndërmarret të gjitha veprimet e nevojshme për të përshtatur menjëherë fletëvotimin dhe materialet përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Me tutje në ankesë deklaron se e konteston Vendimin e KQZ-së nr.01/3689-2025, për miratimin e dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimit në formën që përfshin vetëm gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe në krye, pa përfshirjen e gjuhës turke për komunat ku ajo është në përdorim zyrtar. Parashtuesi i ankesës me tutje thekson se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve Nr.02/L-37, parashikon qartë se, në komunat ku një komunitet gjuhësor përbën së paku 5% të popullsisë, gjuha e atij komuniteti merr status zyrtar në atë komunë dhe përdoret njësoj në gjuhët zyrtare, për më tepër, përjashtimisht, në komunën e Prizrenit gjuha turke ka status zyrtar pavarësisht përqindjes. Ndërsa në komunën e Mamushës, sipas regjistrimit të popullsisë së fundmi, përqindja e popullsisë turke është 93%. Kjo dispozitë krijon një detyrim ligjor për përdorim të barabartë të gjuhës turke në institucione dhe dokumente zyrtare në nivel komunal.

Me tutje në ankesë thekson se sipas Rregullores Nr.10/2024 “Fletëvotimet dhe Broshurat” (si e ndryshuar /plotësuar): përcakton që fletëvotimet dhe broshurat shtypen në të gjitha gjuhët zyrtare në nivel kombëtar dhe lokal, dhe detyron që përveç dy gjuhëve zyrtare në komunat ku ekziston një gjuhë e tretë zyrtare ajo të përfshihet në mënyrë të barabartë në fletëvotime dhe broshura zgjedhore. Kjo rregullore është akt procedural i KQZ dhe traditon rregullimin e qartë operacional për materialet zgjedhore. Ligji Nr.08/L për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton kompetencat e KQZ dhe referon detyrimin për t’i përshtatur materialet zgjedhore në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, gjithashtu përcakton kompetencat e PZAP për shqyrtimin e ankesave zgjedhore. Vendimi i KQZ-së është i kundërligjshëm dhe arbitrar, ku sipas Ligjit Nr.02/L-37 dhe rregulloret zbatuese parshikojnë statusin dhe përdorimin zyrtar të gjuhës turke në nivel komunal (përfshirë rastin e veçantë të Prizrenit). Kur një akt administrativ (si vendimi i KQZ) pengon ose anashkalon këtë përdorim në materialet e rëndësishme zgjedhore që përcakton mënyrën e printimit dhe përfshirjes së gjuhëve. Si rrjedhojë vendimi që prodhon efektin e përshtimit të gjuhës turke në komunat përkatëse është i kundërligjshëm dhe duhet të shfuqizohet. Rregullorja e KQZ nuk mund të interpretohet në mënyrë që të mohojë të drejtat që rrjedhin drejtpërdrejt nga ligji. Rregullorja Nr.10/2024, kërkon përfshirjen e gjuhëve zyrtare në fletëvotime, interpretimi dhe zbatimi i saj duhet të jetë në jenë në harmoni me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Në bazë të argumenteve të mësipërme, KDTP kërkon nga PZAP që të pranojë ankesën si të bazuar dhe të shfuqizojë në pjesën përkatëse Vendimin e KQZ-së nr.01/3689-2025; të urdhërojë KQZ-në që brenda afateve të përcaktuara nga PZAP, të rishikojë dhe ndryshojë dizajnin e fletëvotimit në mënyrë që të përfshijë gjuhën turke për përdorim në komunat ku ajo ka status zyrtar (përfshirë komunat Prizren dhe Mamushë), në përputhje me Ligjin Nr.02/L-37 dhe Rregulloren nr.10/2024. Të marrë masa të menjëhershme procedurale (nëse PZAP e vlerëson të nevojshme) për të parandaluar shpërndarjen ose përdorimin e materialeve/fletëvotimeve të miratuara nga vendimi i kundërshtuar deri sa KQZ të harmonizojë materialet me kërkesat ligjore. Të urdhërojë KQZ-në, që të sigurojë përkthime dhe material të plotë informues në gjuhën turke (përfshirë broshurat, udhëzimet dhe materialet trajnuese për anëtarët e komisioneve) për komunat përkatëse. Të lexohet dhe të merret në konsideratë opinionimi ligjor i shërbimit të KQZ (përfshirë dokumentin e brendshëm të hartuar) por të vlerësohet sipas parimeve të ligjit dhe jo të përdoret si arsyetim për tejkalim të detyrimeve ligjore të prera nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve.

Prova: Kopje e vendimit të KQZ-së Nr.3689-2025 (pjesa e përfshirë për miratim dizajni), Kopje e Opinionit të Shërbimit Ligjor të KQZ.

Në përgjigjen në ankesë KQZ, ndër të tjera thuhet se Ankesa e KDTP nuk bie në fushën e vendimeve që mund të ankimohen në PZAP, konsiderojmë se ankesa në fjalë nuk qëndron as në aspektin e përmbajtjes së saj sepse : Bazuar në kapitullin 1, nenin 5 (Gjuhët) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datën 15 qershor 2008, theksohet se “Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe”. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj. Sipas dispozitave të lartcekura çdo dokument shtetëror që ka karakter kombëtar dhe shtetëror duke përfshirë edhe fletëvotimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës duhet të përgatiten në këto dy gjuhë (Gjuha shqipe dhe gjuha serbe), andaj asnjë gjuhë tjetër nuk mund të shtohet si detyrim kushtetues në nivel kombëtar. Pra, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë miratimit të përmbajtjes së fletëvotimit ka vepruar në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik, duke i përfshirë të dy gjuhët zyrtare në nivel qendror.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë dy gjuhët e vetme me status kushtetues në nivel kombëtar. Si rrjedhojë, çdo procedurë dhe çdo dokument që lidhet me funksionimin e organeve qendrore të shtetit, përfshirë edhe procesin zgjedhor në nivel qendror, duhet të zhvillohet dhe të hartohet në këto dy gjuhë zyrtare. Gjuhët tjera, si gjuha turke, boshnjake dhe rome nëpërputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, mund të kenë status të gjuhës zyrtare në nivel komunal nëse komunitetet përkatëse përbëjnë së paku 5% të popullsisë së komunës, ose status të gjuhës në përdorim zyrtar kur plotësohen kriteret ligjore. Kjo nënkupton se këto gjuhë mund të përdoren për komunikim zyrtar dhe dokumente në nivel lokal, si dhe për proceset zgjedhore komunale.

Në bazë të dispozitave të lartcekura, mundësia për shtypjen e fletëvotimeve në gjuhët tjera përveç gjuhës shqipe dhe serbe, ekziston në raste të caktuara, konkretisht sipas llojit të zgjedhjeve (zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës). Për Zgjedhjet lokale fletëvotimet mund të shtypen edhe në gjuhët tjera, nëse një komunitet përmban së paku 5% të popullsisë së asaj komune. Në këtë rast, edhe sipas praktikës, fletëvotimet për zgjedhjet lokale janë shtypur në gjuhët turke, boshnjake dhe rome. Ndërsa për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës (niveli qendror) gjuhët tjera nuk përdoren në fletëvotim përveç gjuhës shqipe dhe serbe. Gjuhët tjera mund të përdoren vetëm materialet informuese, shoqëruese, me qëllim të informimit të votuesit të atij komuniteti. Në zgjedhjet Për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09 shkurt 2025, përmbajtja e fletëvotimit ka qenë vetëm në të dy gjuhët zyrtare (gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe), ndërsa në zgjedhjet lokale 2025 të mbajtura më 12 tetor 2025, përmbajtja e fletëvotimit ka qenë në të gjitha gjuhët e komuniteteve në Kosovë (gjuha turke, boshnjake, rome). (Shih mostrat e fletëvotimeve për të dy llojet e zgjedhjeve).

Në lidhje me pretendimet e palës Për shkeljen e detyrimit Për përdorimin e barabartë të gjuhës turke në komuant ku ajo ka status zyrtar, nuk qëndrojnë, sepse KQZ ka vepruar në përputhje me nenin 87 paragrafi 8 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme ku përcaktohet se fletëvotimet shtypen në gjuhë zyrtare sipas Ligjit Për përdorimin e gjuhëve, rrjedhimisht ky nen duhet të interpretohet në përputhje me kushtetutën. Pra, nuk mund të prodhoj detyrim që bie në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Si pasojë, në rast të

mospërputhjeve ose konfliktit juridik, dispozitat kushtetuese kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore, në përputhje me parimin e hierarkisë së normave juridike. Prandaj, në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës zbatohen vetëm gjuhët zyrtare (gjuha shqipe dhe gjuha serbe).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa vlerëson se pretendimet ankimore të parashtresës të ankesës, subjektit politik KDTP, në lidhje me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3689-2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Dizajnit dhe Përmbajtjes së Fletëvotimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 28 dhjetor 2025, janë të bazuara. Në këtë vendim, në përmbajtjen e fletëvotimit janë përfshirë vetëm gjuha shqipe dhe gjuha serbe, ndërsa nuk është përfshirë gjuha turke për komunitat ku ajo ka status të gjuhës zyrtare, në veçanti në komunën e Prizrenit dhe të Mamushës.

Paneli vlerëson se pretendimi i KQZ-së, i paraqitur në përgjigjen ndaj ankesës, se ankesa e KDTP-së drejtuar PZAP-it nuk hyn në kategorinë e vendimeve të ankimeshme, është i pabazuar. Kjo për faktin se neni 119 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton qartë se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP...”*.

Pretendimi tjetër i KQZ-së, se sipas Kushtetutës së Kosovës gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë të vetmet gjuhë me status kushtetues në nivel kombëtar, është i pabazuar. Neni 5 paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës përcakton qartë se *“Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj”*. Po ashtu, neni 87 paragrafi 8 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh se *“Fletëvotimet shtypen në të gjitha gjuhët zyrtare në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve...”*.

Neni 1 i Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në mënyrë të qartë përcakton se : *“1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë: i. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike; ii. Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës; iii. Të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor; iv. Karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë kosovare, që paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore. 1.2. Në nivelin komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj”*.

Ndërsa, neni 2.3 i Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në mënyrë të qartë përcakton se: *“Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5% të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do të përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.”*.

Pretendimi i KQZ-së se gjuhët tjera mund të përdoren për komunikim zyrtar dhe dokumente vetëm në nivel lokal, përfshirë edhe proceset zgjedhore komunale, është i pabazuar. Kjo ngase neni 3 i Rregullores Zgjedhore nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024, në mënyrë të qartë përcakton se: *“Paragrafi 4 i nenit 6 të Rregullores bazike ndryshohet si në vijim: Fletëvotimet dhe broshurat shtypen në të gjitha gjuhët zyrtare në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Subjekti politik i certifikuar mund të zgjedhë gjuhën dhe shkrimin në të cilën emri i tij/saj është i shkruar në fletëvotim”*.

Pretendimi i parashtruar nga KQZ në përgjigjen ndaj ankesës, se përdorimi i gjuhëve të tjera përveç shqipes dhe serbe varet nga lloji i zgjedhjeve (zgjedhjet lokale ose zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës), është i pabazuar. Kjo për faktin se KQZ vetë ka krijuar praktikë në përdorimin e gjuhëve zyrtare në përmbajtjen e fletëvotimeve. Në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2014, në përmbajtjen e fletëvotimit ka qenë e përfshirë edhe gjuha turke; e njëjta praktikë është ndjekur edhe në zgjedhjet e vitit 2021. Po ashtu, në opinionin e KQZ-së datë 08.12.2025 lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare në fletëvotimet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025, ndër të tjera theksohet se: *“Bazuar në praktikat e KQZ, duke filluar nga zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të viteve 2014, 2017 dhe 2021, në fletëvotim janë përfshirë gjuha shqipe, gjuha serbe dhe gjuha turke.”*

Duke u mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 1 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, nenin 87.8 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe në rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konstatohet se përfshirja e gjuhës turke në fletëvotimet e zgjedhjeve nacionale për komunat Prizren dhe Mamushë përbën një detyrim kushtetues, ligjor dhe funksional.

Nga kjo rrjedh se gjuha turke gëzon statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në nivel komunal, përfshirë komunat Prizren dhe Mamushë, ku komuniteti turk përbën një shtyllë të rëndësishme historike, numerike dhe kulturore të popullsisë. Ky status ngarkon institucionet publike me detyrimin që të sigurojnë përdorimin e gjuhës turke në të gjitha shërbimet publike, duke përfshirë edhe procesin zgjedhor.

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve garanton qasje të barabartë në dokumente dhe procese publike; për rrjedhojë, mos ofrimi i fletëvotimit në gjuhën turke në Prizren dhe Mamushë do të cenonte këtë parim, do të krijonte bazë për diskriminim dhe do t'i privonte votuesit e komunitetit turk nga informacioni i kuartë dhe i plotë gjatë procesit zgjedhor.

Paneli vlerëson se përfshirja e gjuhës turke në fletëvotimet në nivel nacional duhet të shihet si mekanizëm që u mundëson anëtarëve të këtij komuniteti realizimin e të drejtave të tyre në nivelin lokal ku ata banojnë, duke garantuar në të njëjtën kohë ushtrimin e të drejtave të tyre gjuhësore. Ky proces siguron pjesëmarrje të barabartë në procesin demokratik, eliminon barrierat gjuhësore për votuesit dhe është në përputhje me standardet e barazisë, mos diskriminimit dhe përfshirjes. PZAP thekson se përdorimi i gjuhës turke në fletëvotim në këto komuna është një instrument i rëndësishëm për garantimin e integritetit të votës dhe shmangien e gabimeve të mundshme që mund të lindin për shkak të pengesave gjuhësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 1, dhe 5, nenit 87 par.8 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 2.3 të Ligjit nr.02/L-37 për përdorimin e Gjuhëve, nenin 5 par.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e aprovuar ankesën si të bazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.8/2025 datë 10.12.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.